



SI TË APLIKOSH PËR LEJE NDËRTIMI

UDHËZUES PËR PROFESIONISTËT DHE QYTETARËT



BASHKIA
TIRANË

Udhëzuesi për profesionistët dhe qytetarët:
“Si të aplikosh për Leje Ndërtimi”

AUTOR

Drejtorja e Përgjithshme e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit,
Bashkia Tiranë.

UDHËHEQËS TË PROCESIT:

Ditjon Baboçi, Drejtor i Përgjithshëm

Drejtorja e përgjithshme e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit

Frida Pashako, Drejtor

Drejtorja e Kontrollit të Zhvillimit të Territorit

Anisa Mançe, Pergjegjes Sektor

Sektor i Shqyrtimit të Aplikimeve, Drejtorja e Kontrollit të Zhvillimit të Territorit

Enkelejda Murtaç, Pergjegjes Sektor

Sekretariati Teknik, Drejtorja e Kontrollit të Zhvillimit të Territorit

Devis Agaraj, Përgjegjës Sektor

Sektor i Makroplanifikimit, Drejtorja e Planifikimit të Territorit

DREJTUES I GRUPIT TË PUNËS:

Alba Metoja, Specialiste

Sektor i Shqyrtimit të Aplikimeve:

Iva Tavanxhiu, Specialiste

Sektor i Makroplanifikimit

GRUPI I PUNËS:

Kleant Bibolli, Griselda Gjika, Mirela Gjika, Ana Hoxha, Eris Qazimi (Bejo), Adelina Farruku, Frida Dibra, Erlend Baballëku, Alda Zholi, Boriana Vrusho, Melania Keçi, Albana Dosti, Edis Skuqi, Matilda Sotiri (Zazani), Diana (Goshi) Prifti, Enkeleda Dino, Ornela Spaho, Anjeza Bashi, Luçiana Troplini, Mimoza Musliaka

REALIZIMI GRAFIK:

Iva Tavanxhiu

Tiranë, 2018

SHËNIM I RËNDËSISHËM

Roli i këtij udhëzuesi është orientues për mënyrën e aplikimit të Lejes së Ndërtimit dhe do të jetë vazhdimisht në proces përditësimi në varësi të ndryshimit të legjislacionit, rregulloreve në zbatim të ligjeve përkatëse në fuqi, urdhëresave të ndryshme apo koncepteve që kanë nevojë të spjegohen.

Sugjerimet e dhëna në këtë udhëzues nuk janë shteruese, pasi vetë rastet e aplikimit për *Leje Ndërtimi* janë nga më të ndryshmet dhe trajtimet e tyre nuk janë standarte.

Referencat ligjore të cituara në këtë udhëzues i përkasin kohës së përgatitjes së tij, prandaj çdo përdorues i këtij udhëzuesi duhet të jetë i kujdesshëm t'i referohet bazës ligjore të përditësuar nga burimet zyrtare në momentin e përdorimit të tij.

TABELA E PËRMBAJTJES

Hyrje	6
HAPI 1 - Kontrolli i kushteve të zhvillimit & përcaktimeve për pronën referuar PPV Tiranë; PDV faza I & PDV faza II; lejes së zhvillimit	13
HAPI 2 - Pajisja me vërtetimin e pronësisë nga Hipoteka (Zyra vendore e regjistrimit të pasurive të paluatshme)	17
HAPI 3 - Aplikimi për gen-plan azhornimi në Bashkinë e Tiranës	21
HAPI 4 - Hartimi i projekteve teknike të strukturës	25
HAPI 5 - Përgatitja e dokumentacionit tekniko - ligjor & Aplikimi online	37
HAPI 6 - Shqyrtimi i kërkesës dhe afatet kohore	45
Hapi 7 - Pagesa e tarifës së aplikimit, pagesa e taksës së ndikimit në infrastrukturë	51
Permbledhja e procesit të aplikimit për leje ndërtimi	59

➤ HYRJE

Udhëzuesi për profesionistët dhe qytetarët u përgatit nga Bashkia e Tiranës me mbështetje teknike të Drejtorisë së Përgjithshme të Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit.

QËLLIMI I UDHËZUESIT

Udhëzuesi “Si të aplikosh për Leje Ndërtimi” i vjen në ndihmë profesionistëve të fushës si planifikues urbanë, urbanistë, arkitektë dhe të interesuarve që aplikojnë për leje ndërtimi duke i udhëzuar për bazën ligjore, dokumentacionin e nevojshëm për pajisjen me leje, autoritetet të cilët kanë të drejta vendimmarrje, afatet e kërkuara, etj.

MENYRA TË TJERA INFORMIMI PËRVEÇ KËTIJ UDHËZUESI

Për çdo pyetje apo informim mbi mënyrën e aplikimit për Leje Ndërtimi mund të interesoheni pranë:

- Zyrave të Komunikimit me Qytetarët pranë Bashkisë së Tiranës
- Portalit zyrtar të Bashkisë së Tiranës:

www.tirana.al

➤ UDHËZUES TË TJERË APLIKIMI PER LEJE

Ky udhëzues është pjesë e një pakete informative për zbatimin e bazës tekniko - ligjore sipas kushteve të zhvillimit të përcaktuara në legjislacionin dhe rregulloret përkatëse në fuqi, së bashku me Udhëzuesin “Si të aplikosh për Leje Zhvillimi”, Udhëzuesin “Si të aplikosh për konfirmim e Akt-kontrolleve”, Udhëzuesin “Si të aplikosh për çertifikatë përdorimi”, Udhëzuesin “Si të aplikosh për Plan të Detajuar Vendor”, Udhëzuesin “Si të aplikosh për Deklaratë Paraprake për Kryerje Punimesh” dhe Udhëzuesin “Si të aplikosh për Gen-plan Azhornimi”.



➤ ÇFARË ËSHTË LEJA E NDËRTIMIT?

“ Leja e ndërtimit është akti i miratimit të kërkesës për leje ndërtimi dhe i lejimit të punimeve përkatëse.

Leja e ndërtimit është e nevojshme për çdo ndërtim, riparim, restaurim apo prishje të objekteve ekzistuese, instalim apo ngritje të ndërtimeve të përkohshme, me përjashtim të punimeve që nuk kanë nevojë të pajisen me leje ndërtimi. ”

➤ NË ÇFARË RASTI APLIKOJMË PËR LEJE NDËRTIMI?

1/ Mundësia e aplikimit **DIREKT** për leje ndërtimi (pa leje zhvillimi) vlen për rastet e mëposhtme:

- **Kërkesë për rikonstrukcion, riparim dhe restaurim të strukturave ekzistuese** që çojnë në krijimin e një strukture tërësisht ose pjesërisht të ndryshme nga ajo e mëparshme dhe që kanë si pasojë shtimin e njësive dhe / ose ndryshimin e vëllimit ndërtimor, sipërfaqes së ndërtimit (jo gjurmës), pamjes së jashtme të objektit, të përdorimit ose të sistemit konstruktiv.

! KUJDES

Gezimi i të drejtës së pronës nuk përkon me të drejtën për zhvillim të saj.

◀ SHËNIM

Punimet e përjashtuara nga pajisja me leje ndërtimi, listohen në Ligjin nr. 107/2014 dt. 31/07/2014 (i ndryshuar) “Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit”, neni 41.

Shiko udhëzuesin “Si të aplikosh për Deklaratë Paraprake për Kryerje Punimesh”

SHËNIM ▶

Nëse rasti juaj nuk klasifikohet si aplikim për leje ndërtimi, referojuni udhëzuesve të tjerë për aplikim për leje (faqe 7).

- **Kërkesë për ndryshimin e aktiviteteve dhe funksioneve të njësisë individuale**, me kusht mosndryshimin e sistemit konstruktiv, në bazë të përputhshmërisë me kategoritë dhe nënkategoritë e përdorimit të tokës të përcaktuara nga PPV-ja ose PDV-ja.

- **Rishikimi i kushteve të lejes** gjate ndërtimit. Kërkesa duhet të jetë në përputhje me dokumentet e planifikimit në fuqi.

- **Kërkesë për ristrukturimin e strukturave ekzistuese** ku përfshihet aplikimi për shtesë një kat, në përputhje me përcaktimet e PPV Tiranë për numrin e kateve dhe distancat minimale nga strukturat ekzistuese dhe vijës së pronës.

- **Kërkesë për rindërtim e strukture**, që konsiston në prishjen dhe rindërtimin me të njëjtin vëllim dhe formë të objektit të mëparshëm.

- **Kërkesë për realizimin e rrethimit të pronës**, ndryshimin e llojit të mbulesës së strukturës (çati ose soletë).

- **Kërkesë për prishje të objektit ekzistues**


2/ Në të gjitha rastet e aplikimit, sipas përcaktimeve të Lejes së Zhvillimit për parcelat për të cilat kërkohet ndërtimi.”

> MËNYRA E APLIKIMIT

Aplikimi për leje ndërtimi kryhet **VETËM** në **MËNYRË ELEKTRONIKE** nëpërmjet **PORTALIT ONLINE E-LEJE** pjesë e platformës **E-ALBANIA**.

Ky portal mundëson shërbimin me një ndalese dhe procedura të thjeshtuara, transparente dhe të shpejta, redukton pengesat administrative dhe përmirëson praktikën e aplikimit për lejet përkatëse.

www.e-albania.al



01

**KONTROLLI I KUSHTEVE TË ZHVILLIMIT
& PËRCAKTIMEVE PËR PRONËN**
REFERUAR PPV TIRANË; PDV FAZA I &
PDV FAZA II; LEJES SË ZHVILLIMIT



➤ PËRCAKTIMI I KUSHTEVE TË ZHVILLIMIT PËR PRONËN KU KËRKOHET ZHVILLIMI

Përpara se të aplikoni për Leje ndërtimi, kontrolloni kushtet e zhvillimit që përcaktohen në rast se:

1/ Prona që ju doni të zhvilloni ndodhet në **njësi strukturore subjekt PDV-je**, përcaktuar si e tillë nga Plani i Përgjithshëm Vendor i Bashkisë Tiranë (TR030), kushtet për ndërtim i përcakton hartimi i PDV-së (Faza I dhe Faza II).

ose


2/ Prona juaj ndodhet në njësi strukturore që **nuk është subjekt PDV-je**, ju mund të aplikoni direkt për Leje Zhvillimi, e më pas për Leje Ndërtimi.

◀ SHËNIM

Për hartimin dhe aplikimin e PDV Faza 1, PDV Faza 2 dhe Lejes së Zhvillimit, referojuni Udhëzuesve “Si të aplikosh për Plan të Detajuar Vendor Faza 1”, “Si të aplikosh për Plan të Detajuar Vendor Faza 2” dhe “Si të aplikosh për Leje Zhvillimi”.

RASTI 1

Prona që doni të zhvilloni ndodhet në **NJËSI STRUKTURORE SUBJEKT PDV-je**.



RASTI 2

Prona që doni të zhvilloni ndodhet në njësi strukturore që **NUK ËSHTË SUBJEKT PDV-je**.



02 PAJISJA ME VËRTETIMIN E PRONËSISË NGA HIPOTEKA / ZYRA VENDORE E REGJISTRIMIT TË PASURIVE TË PALUAJTSHME



ÇERTIFIKATA E PRONËSISË

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ZYRA E REGJISTRIMIT TE PASURISË SË PALUAJTSHME

ÇERTIFIKATË
PËR VËRTETIM PRONËSIE

1002180

Zyra e Regjistrimit _____ Zona Kadastrale Nr. _____
 Numri i Pasurisë _____ Volumi _____ Faqe _____
 Adresa e Pasurisë _____
 Lloji i Pasurisë _____
 Sipërfaqja Totale _____
 Nga kjo : Sa Truall _____ Nga kjo : Sa Ndërtesa _____
 Nqs pallat : Kuota e pjesëmarrjes _____ %

KJO ÇERTIFIKATË LËSHOHET PËR TË VËRTETUAR QË

Zoti (Zotërinjtë)	Emri	Atësia	Mbiemri	Pjesa	Adresa

- është pronar i _____
 - janë bashkëpronarë sipas pjesëve më lart _____
 - është përfaqësues i familjes e cila ka në pronësi _____
 - kufizimet e pasurisë janë : V _____, L _____, J _____, P _____

Kjo certifikatë plotësohet në përputhje me Ligjin e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme.
 Kjo certifikatë lëshohet sipas kërkesës së paraqitur nga i (të) Interesuari (t) më date _____ Nr. _____

Lëshuesi i certifikatës
 REGJISTRUESI

Data e lëshimit të certifikatës _____

HARTA TREGUESE E REGJISTRIMIT

HARTA TREGUESE E REGJISTRIMIT
(Fraqment)

ZYRA E REGJISTRIMIT TE PASURIVE TE PALUEJTSHME TIRANË

REGJISTRUES

A. IDENTIFIKIMI I PASURISË
 ZONA KADASTRALE _____
 NR. I PASURISË: _____ VOL _____ FQ _____
 INDEKSI I HARTES: _____ SHKALLA: _____
 ADRESA E PASURISË Rrethi _____ Q/F _____
 Rr/L: _____ P/K: _____ SH _____ K _____ Ap _____

B. KUFIZIMET
 V: _____
 L: _____
 J: _____
 P: _____

C. PRONARI
 D. Data: _____ Ora: _____

Z.V.R.P.P
TIRANË

X: 400385.876 Y: 4579287.846

! KUJDES

Kartela e Pasurise se Paluajtshme dhe Harta Treguese e Regjistrimit duhet te jene te rifreskuara të 3 muajve te fundit dhe te njesuara me originalin (noterizuara).

SHËNIM

Në rast se në Kartelën e Pasurisë së Paluajtshme, pronari ka shënime në “Seksionin e qerave, në përdorim, marrëveshje kufizuese, serviturave dhe interesave të tjera” apo në “Seksiionin e hipotekave, vendimeve të gjykatës, kufizimeve, etj”, do të ketë kërkesa të vecanta (vërtetime apo çdo shkresë tjetër që është e nevojshme) në varësi të komenteve përkatëse nga autoriteti përgjegjës.

KARTELA E PASURISË SË PALUAJTSHME

KARTELA E PASURISË SE PALUAJTSHME

A - SEKSIONI I IDENTIFIKIMIT TË PASURISË
 Zona Kadastrale: _____ NR. I PASURISË: _____ Vizion nga: Vol _____, Fq _____
 Indeksi i Hartes: _____ deri në: vol _____, Fq _____
 Adresa e Pasurisë: Rrethi _____ Q/F _____ PER UNDIMT/RE (data): _____
 Rr/L: _____ P/G _____ SH _____ K _____ Ap _____ Përshkrim i veçantë: _____

B - SEKSIONI I PËRSHKRIMIT TË PASURISË
 Lloji i Pasurisë: _____ Brenda V.K.N.: _____, Ref: _____

Sip. Totale e Pasurisë	Nga Sip. Totale: sa Truall	Nga Sip. Truall: sa Ndërtesa	Per pjesen e përbahtë
1. _____ m ²	1. _____ m ²	1. _____ m ²	_____ %
Ref: _____	Ref: _____	Ref: _____	_____ %
2. _____ m ²	2. _____ m ²	2. _____ m ²	_____ %
Ref: _____	Ref: _____	Ref: _____	_____ %
3. _____ m ²	3. _____ m ²	3. _____ m ²	_____ %
Ref: _____	Ref: _____	Ref: _____	_____ %
4. _____ m ²	4. _____ m ²	4. _____ m ²	_____ %
Ref: _____	Ref: _____	Ref: _____	_____ %

C - SEKSIONI I PRONËSISË

Nr. Dok	Data Regjistrimit	Emri	Atësia	Mbiemri	Nr. Pasap	I/F/B	Adresa e Pronarit	Shuma e Paguar	Data e Lësh. Certifikatës	Shënime	Firma

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E DREJTËSISË
ZYRA QENDRORE E REGJISTRIMIT TË PASURIVE TË PALUAJTSHME TIRANË
Adresa: Rruga Jordani Misja, Tiranë

SHËNIM: Kjo kopje e kartelës së A4, ka fuqi të njëjtte me origjinalin e caktuar në zyrën tonë. Në regjistrin Ve _____, Faqe _____, Zona Kadastrale _____, Qyteti Tiranë

REGJISTRUESI

D - SEKSIONI I QIRAVE, NE PËRDORIM, MARRËVESHJEVE KUFIZUESE, SERVITURAVE DHE INTERESAVE TE TJERA

Nr. Dok	Data Regjistrimit	Tipi	Përshkrimi	Data e Lësh. Certifikatës	Shënime	Firma

E - SEKSIONI I II/ POTEKAVE, VENDIMEVE TE GJYKATES, KUFIZIMEVE, ETJ

Nr. Dok	Data Regjistrimit	Tipi	Përshkrimi	Data e Lësh. Certifikatës	Shënime	Firma

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E DREJTËSISË
ZYRA QENDRORE E REGJISTRIMIT TË PASURIVE TË PALUAJTSHME TIRANË
Adresa: Rruga Jordani Misja, Tiranë

SHËNIM: Kjo kopje e kartelës së A4, ka fuqi të njëjtte me origjinalin e caktuar në zyrën tonë. Në regjistrin Ve _____, Faqe _____, Zona Kadastrale _____, Qyteti Tiranë

REGJISTRUESI

03 APLIKIMI PËR RIKONFIRMIM GEN-PLAN AZHORNIMI NË BASHKINË E TIRANËS



GEN-PLANI I AZHORNIMIT lëshuar nga Kadastra e Bashkisë Tiranë, është plani topografik i cili paraqet në rafshin horizontal projeksionin ortogonal të objektit / objekteve në lartësi (të plotësuar me kuota), së bashku me relievin e zonës përreth, referuar përcaktimeve të studimeve në fuqi (PPV, PDV Faza 1, PDV Faza 2, Leje Zhvillimi).

Ju mund të keni nevojë të aplikoni për rikonfirmim gen-plani në rastet kur:

- 1/ Ka kaluar afati 3 muor** i vlefshmërisë së Gen-planit nga data e miratimit të tij nga Bashkia e Tiranës
- 2/ Kur prona juaj ndodhet në njësi subjekt PDV-je**, Bashkia e Tiranës e konfirmon Genplanin, bazuar në PDV Faza II dhe leje zhvillimi të miratuar.
- 3/ Kur prona juaj ndodhet në njësi që nuk është subjekt PDV-je**, rikonfirmimi i Genplanit bëhet në bazë të rrjetit rrugor të përcaktuar sipas PPV-së.

DOKUMENTAT E NEVOJSHËM PËR APLIKIMIN PËR RIKONFIRMIM GEN - PLAN:

- 1/ VËRTETIMIN E PRONËSISË NGA HIPOTEKA (SHIKO HAPIN 2)**
(ZYRA VENDORE E REGJISTRIMIT TË PASURIVE TË PALUATSHME - ZVRPP)
 - *çertifikata e pronesisë*
 - *kartela e pasurisë së paluajtshme*
 - *harta treguese e regjistrimit*

2/ FOTOKOPJE E GEN-PLANIT të nxjerrë nga Bashkia e Tiranës

! KUJDES

Përpara aplikimit për azhornim në Bashkinë Tiranë aplikanti duhet të ketë kryer nëpërmjet një eksperti gjeodet të licensuar rilevimin topografik të zonës.

Në rast se zona juaj e interesit ka ndryshuar kufijtë e menaxhimit, ju duhet të aplikoni për Genplan Azhornimi të ri.


Referojuni Udhëzuesit "Si të aplikosh për Gen-plan Azhornimi"

◀ SHËNIM

Dokumentat që vërtetojnë pronësinë duhet të jenë të noterizuara dhe të 3 muajve të fundit.

FRAGMENT NGA PLANIMETRIA E TIRANËS, ZK. 8190, TR; Q-14, VITI 2018, SH.1:500

Porositës:
Nr. Prot.
Nr. Dok.



SHËNIME
GEN-PLANI SHOQËROHET GJITHMONË ME FRAGMENTIN E HARTËS NË SHKALLË 1:2000
KY GEN-PLAN VLEN VETËM PËR LEJE PËR NDËRTIMI
PJESA E KONTURUAR ME VIJË TË NDËRPRERË ËSHTË PRONA E AZHORNUAR NË TERREN
PROFILAT E RRUGËVE JANË HEDHUR SIPAS PLANIT TË DETAJUAR VENDOR TË NËN-NJËSISË STRUKTUREORE

 REPUBLIKA E SHQIPËRISË BASHKIA E TIRANËS	DREJTOR I KADASTRËS		
	PËRGI I SEKTORIT TË KADASTRËS URBANE		
DREJTORIA E KADASTRËS	PËRGI I SEKTORIT TË MIKROPLANIFIKIMIT		
	SPECIALISTI I SEKTORIT TË PROJEKTIMIT INZHINIERIK		
	ARKITEKT		
Datë:	AZHORNOI		

04 HARTIMI I PROJEKTEVE TEKNIKE TË STRUKTURËS



➤ PROJEKTET TEKNIKE TË STRUKTURËS:

4.1/ PROJEKTI ARKITEKTONIK, përmban:

- **Planvendosjen e strukture** (shkalla 1/500) me dimensionet, distancat, dhe pronat perkatese, **mbivendosur genplanit te azhornuar nga Bashkia e Tiranës**, e firmosur elektronikisht nga projektuesi.
- Plani i piketimit të strukturës
- Plani i organizimit të punimeve
- Plani i sistemimeve
- Planimetrite me dimensione, kuota dhe emërtimet përkatëse
- Planimetrite me kuotat dhe mobilimet perkatese;
- Plani i mbulimit me kuotat perkatese ne plan dhe kuotat ne parapete dhe mbi elementet teknike si dhe kullimet
- Fasadat teknike me kuota dhe dimensione
- Paraqitja e prerjeve teknike të sturkutës
- Paraqitje të detajeve të elementeve konstruktivë të strukturës (si p.sh detaje podrumi, kat përdhe, ballkone, tarraca, dysHEME, shkalle, grilë, vetratë, pishinë, gjelbërim, oborr, etj.)
- Perspektiva, rendera, fotomontazh dhe vizualizime të projektit

! KUJDES

Parametrat urbanistikë duhet të jenë në përputhje me përcaktimet e Lejes së Zhvillimit, ku janë miratuar treguesit e zhvillimit për pronën / pronat tuaja.

- **Grafiku i realizimit të punimeve**, i firmosur nga drejtuesi teknik i punimeve dhe i nënshkruar elektronikisht nga projektuesi.
- **Preventivi i realizimit të punimeve** (sipas standardit të Bashkisë Tiranë)
- **Relacioni teknik i arkitektit**, ku përfshihet tabela e të dhënave teknike.
- **Licensa individuale e arkitektit** me kategoritë përkatëse të punimeve që do të kryhen, brenda afatit të vlefshmërisë.
- **Vërtetim nga QKB** (Qendrës Kombëtare të Regjistrimit) e regjistrimit të projektuesit.
- **Deklarata e përgjegjësisë profesionale të arkitektit**, me anë të cilës nën përgjegjësinë e tij, deklaron se e ka hartuar këtë projekt, konform të gjithë standarteve dhe normave teknike në fuqi, e nënshkruar elektronikisht
- **Kopje e policës së sigurimit të projektuesit**, për mbulimin e përgjegjësive profesionale.

◀ SHËNIM

Shkarkoni standardin e preventivit të realizimit të punimeve, në

www.tirana.al

në folderin e Udhëzuesit "Si të aplikosh për Leje Ndërtimi".

4.2/ PROJEKTI KONSTRUKTIV I STRUKTURËS, si dhe bashkëlidhur:

Projekti konstruktiv me dokumentacionin si vijon:

- Planin e piktimit të kollonave dhe mureve b/a ne çdo kat
- Planin e përgjithshëm të themeleve
- Armimet e themeleve
- Planet e strukturave në çdo kat
- Armimet e të gjithë elementeve të struktures(kollona, mure, trarë, shkallë dhe soleta b/a)
- Mbrojtja e objekteve përreth objektit që do të ndërtohet, në rast nevoje (mure mbajtëse, pilota, palankola etj.)

- **Relacioni teknik shpjegues** dhe llogaritjet përkatëse.
- **Licensa individuale e inxhinierit konstruktor** me kategoritë përkatëse të punimeve që do të kryhen, brenda afatit të vlefshmërisë.
- **Vërtetim nga QKB** (Qendrës Kombëtare të Regjistrimit) e regjistrimit të projektuesit konstruktiv
- **Deklaratë e përgjegjësisë profesionale, e inxhinierit konstruktor, e nënshkruar elektronikisht**, me anë të cilës nën përgjegjësinë e tij profesionale, deklaron se e ka hartuar këtë projekt, konform të gjitha standarteve dhe normave teknike në fuqi.
- **Kopje e policës së sigurimit të inxhinierit konstruktor**, për mbulimin e përgjegjësive profesionale.

- **Studimi sizmolog - inxhinierik**
Bashkëlidhur studimit:
- **Licensa individuale e inxhinierit sizmolog (e noterizuar)** me kategoritë përkatëse të punimeve që do të kryhen, brenda afatit të vlefshmërisë, e firmosur elektronikisht.

- **Vërtetim nga QKB** (Qendrës Kombëtare të Regjistrimit) e regjistrimit të inxhinierit sizmolog, e firmosur elektronikisht.
- **Vërtetim i NIPT-it**, i firmosur elektronikisht
- **Polica e sigurimit** e inxhinierit sizmolog, e firmosur elektronikisht

- **Studimi gjeologo-inxhinierik**
Bashkëlidhur studimit:
- **Licensa individuale e inxhinierit gjeolog (e noterizuar)** me kategoritë përkatëse të punimeve që do të kryhen, brenda afatit të vlefshmërisë.
- **Vërtetim nga QKB** (Qendrës Kombëtare të Regjistrimit) e regjistrimit të inxhinierit gjeolog, e firmosur elektronikisht.
- **Vërtetim i NIPT-it**, i firmosur elektronikisht
- **Polica e sigurimit** e inxhinierit gjeolog, e firmosur elektronikisht

4.3/ PROJEKTI HIDRO-SANITAR I STRUKTURËS, si dhe bashkëlidhur:

- **Projekti hidroteknik** duhet të përmbajë materialin e mëposhtëm:
 - Planimetri e rrjetit të furnizimit me ujë e plotësuar me dimensionimin e tubave dhe nyjeve
 - Skema e plotë teknike e lidhjes së rrjetit të Furnizimit me Ujë
 - Planimetri e rrjetit të shkarkimeve K.U.Z e plotësuar me dimensionimin e tubave dhe nyjeve
 - Skema e plotë teknike e lidhjes së rrjetit K.U.Z
 - Planimetri dhe detaj i lidhjes me rrjetin K.U.Z të Qyetit
 - Plani i rrjetit për largimin e ujrave të shiut
 - Planimetri dhe detaj i lidhjes me rrjetin K.U.B të Qyetit (ky material nuk nevojitet në rastet kur kanalizimet kryesore janë të kombinuara)
- **Relacioni teknik** shpjegues ku përfshihen llogaritjet për konsumin e parashikuar për ujë të pishëm dhe volumin e rezervuarëve.
- **Licensa individuale e inxhinierit hidroteknik** me kategoritë përkatëse të punimeve që do të kryhen, brenda afatit të vlefshmërisë.
- **Vërtetim nga QKB** (Qendrës Kombëtare të Regjistrimit) e regjistrimit të inxhinierit hidroteknik .
- **Deklarata e përgjegjësisë profesionale e inxhinierit hidroteknik**, me anë të cilës nën përgjegjësinë e tij profesionale, deklaron se e ka hartuar këtë projekt, konform të gjithë standarteve dhe normave teknike në fuqi, **e nënshkruar elektronikisht**.
- **Kopje e policës së sigurimit të inxhinierit hidroteknik**, për mbulimin e përgjegjësive profesionale.

4.4/ PROJEKTI ELEKTRIK I STRUKTURËS, si dhe bashkëlidhur:

- Plani i ndriçimit të katit tip
- Plani i prizave të secilit kat
- Plani i Tel.Telev.Citof të secilit kat
- Plani i furnizimit të secilit kat
- Rrjeti kryesor i Tel.Telev.Citof të secilit kat
- Skemat elektrike të boksit të matjeve
- Skemat elektrike të boksit të dyqaneve
- Skema elektrike e kuadrit të apartamenteve
- Skema elektrike e kuadrit të dyqaneve
- Instalimet e sistemit të mbrojtjes nga shkarkimet atmosferike
- Detajet e montimit të sistemit rufe-prites
- Detajet e instalimeve elektrike
- **Relacioni teknik** shpjegues.
- **Licensa individuale e inxhinierit elektrik** me kategoritë përkatëse të punimeve që do të kryhen, brenda afatit të vlefshmërisë.
- **Vërtetim nga QKB** (Qendrës Kombëtare të Regjistrimit) e regjistrimit të inxhinierit elektrik.
- **Deklarata e përgjegjësisë profesionale e inxhinierit elektrik**, me anë të cilës nën përgjegjësinë e tij profesionale, deklaron se e ka hartuar këtë projekt, konform të gjitha standarteve dhe normave teknike në fuqi, **e nënshkruar elektronikisht**.
- **Kopje e policës së sigurimit të inxhinierit elektrik**, për mbulimin e përgjegjësive profesionale.

4.5/ PROJEKTI I NGROHJE-VENTILIMIT TË STRUKTURËS, si dhe bashkëlidhur:

- **Projekti teknik** për secilin kat i ngrohje - ventilimit.
- **Relacioni teknik** shpjegues.
- **Licensa individuale e inxhinierit mekanik** me kategoritë përkatëse të punimeve që do të kryhen, brenda afatit të vlefshmërisë.
- **Vërtetim nga QKB** (Qendrës Kombëtare të Regjistrimit) e regjistrimit të inxhinierit mekanik.
- **Deklarata e përgjegjësive profesionale e inxhinierit mekanik**, me anë të cilës nën përgjegjësinë e tij profesionale, deklaron se e ka hartuar këtë projekt, konform të gjithë standarteve dhe normave teknike në fuqi, **e nënshkruar elektronikisht**.
- **Kopje e policës së sigurimit e inxhinierit mekanik**, për mbulimin e përgjegjësive profesionale.

4.6/ RAPORT I VLERËSIMIT TË NDIKIMIT NË MJEDIS (VNM)

Për miratimin e lejes apo konfirmimin nga Agjencia Rajonale Mjedisore / Ministria e Mjedisit, duhet të aplikoni me dokumentat e mëposhtme pranë ARM, përpara aplikimit për leje ndërtimi.

- **Relacioni i vlerësimit të ndikimit në mjedis**.
- **Licensa individuale e ekspertit të mjedisit** me kategoritë përkatëse të punimeve që do të kryhen, brenda afatit të vlefshmërisë.
- **Vërtetim nga QKB** (Qendrës Kombëtare të Regjistrimit) e regjistrimit të vlerësuesit, firmosur me vulë, gjithashtu i firmosur elektronikisht nga eksperti i mjedisit.
- **Çertifikata e ekspertit të VNM**
- **Deklaratë e përgjegjësive profesionale** e hartuesit të vlerësimit të ndikimit në mjedis, e nënshkruar elektronikisht, me anë të cilës nën përgjegjësinë e tij profesionale, deklaron se e ka

◀ SHËNIM

Sigurohuni nëse rasti juaj klasifikohet për projektet që i nënshtrohen procedurës së thelluar të vlerësimit të ndikimit në mjedis apo Vendimi i Agjencisë Kombëtare të Mjedisit për VNM-në paraprake referuar Ligjit Nr. 10 440, datë 7.7. 2011 "Për vlerësimin e ndikimit në mjedis".

hartuar këtë studim, konform të gjithë standarteve dhe normave teknike në fuqi.

- **Polica e sigurimit**, e firmosur elektronikisht nga eksperti i mjedisit.

4.7/ PROJEKTI I MBROJTJES KUNDRA ZJARRIT TË STRUKTURËS

Projekti i mbrojtjes kundra zjarrit duhet të jetë i miratuar nga Drejtoria e Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimi (PMNZSH), i nënshkruar elektronikisht nga eksperti, si dhe bashkëlidhur:

- **Relacioni teknik** shpjegues.
- **Licensa individuale e ekspertit zjarrëfikës**, me kategoritë përkatëse të punimeve që do të kryhen, brenda afatit të vlefshmërisë.
- **Vërtetim nga QKB** (Qendrës Kombëtare të Regjistrimit) e regjistrimit të projektuesit.
- **Deklarata e përgjegjësive profesionale e ekspertit zjarrëfikës**, me anë të cilës nën përgjegjësinë e tij profesionale, deklaron se e ka hartuar këtë projekt, konform të gjithë standarteve dhe normave teknike në fuqi, **e nënshkruar elektronikisht**.
- **Kopje e policës së sigurimit të ekspertit zjarrëfikës**, për mbulimin e përgjegjësive profesionale.

➤ PREVENTIVAT E REALIZIMIT TË PUNIMEVE

DPPZHT për të orientuar mbi hartimin e preventivave për realizimin e punimeve, ka hartuar draftet e mëposhtme:

1/ Preventiv punimesh per rikonstrukcion dhe shtese (kati ose / dhe anesore)

2/ Preventiv punimesh per rikonstrukcion

3/ Preventiv punimesh per godina banimi dhe sherbimi deri ne 250m²
(me pishine dhe mur rrethues –opsional sipas kerkeses)

4/ Preventiv punimesh per godina industriale deri ne 250m²
(me mur rrethues – opsional sipas kerkeses)

5/ Preventiv punimesh per godina banimi dhe sherbimi mbi 250 m².

◀ SHËNIM

Preventivat përkatës mund ti shkarkoni në:

www.tirana.al

në folderin e Udhëzuesit “Si të aplikosh për Leje Ndërtimi”.

05 PËRGATITJA E DOKUMENTACIONIT TEKNIKO - LIGJOR & APLIKIMI ONLINE



➤ DOKUMENTET PËR APLIKIMIN ONLINE:

- 1/ Formati i aplikimit** i nënshkruar elektronikisht
- 2/ Prokura ose autorizim** nga zhvilluesi, në emër të aplikantit (projektuesit) për kryerjen e aplikimit për leje ndërtimi.
- 3/ Leja e zhvillimit e miratuar/ PDV. SHIH HAPIN 01**
- 4/ Dokument që vërteton të drejtat pasurore** të pronës/ave që marrin pjesë në zhvillim dhe, nëse ka, kopje të marrëveshjeve për pronën si: *çertifikata e pronësisë, kartela e pronësisë & harta treguese.* (SHIKO HAPIN 02)
- 5/ Historiku i pronës**, nëse kërkohet
- 6/ Kontratë sipërmarrje**, e lidhur midis zhvilluesit, pronarëve të truallit (apo përfaqësuesit të tyre me prokurë) dhe subjektit ndërtues që do të kryej punimet, e cila duhet të jetë origjinale dhe e lidhur para noterit.
- 7/ Deklaratë noteriale për kallkan** në rastet kur është i nevojshëm.
- 8/ Deklaratë noteriale për prishjen e objekteve ekzistues** në rastet kur zhvillimi parashikon prishjen e tyre për ndërtimin e strukturës së re.
- 9/ Licensa e subjektit ndërtues**, me kategoritë përkatëse të punimeve që do të kryhen, brenda afatit të vlefshmërisë. Subjekti duhet të jetë i regjistruar pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit dhe duhet të paraqesë ekstraktin e regjistrimit në QKB të 3 muajve të fundit.

- 10/ Vërtetim nga Drejtoria e Përgjithshme e Taksave dhe Tarifave Vendore**, që subjekti ndërtues ka shlyer taksat dhe tarifavat vendore, të parashikuara nga pushteti vendor. Subjektet të cilët nuk janë të regjistruar në Bashkinë e Tiranës të paraqesin vërtetim për hapjen e niptit sekondar, në mënyrë që të paguhen detyrimet përkatëse pranë Bashkisë Tiranë.
- 11/ Vërtetimet nga OSHEE**
 - Vërtetim që subjekti ndërtues nuk ka detyrime të papaguara
 - Vërtetim që zhvilluesi nuk ka detyrime të papaguara
 - Vërtetim nga OSSHE për firmen (nëse aplikohet me NIPT)
- 12/ Genplani** i lëshuar nga Bashkia Tiranë (SHIKO HAPIN 03)
- 13/ Plani i vendosjes së strukturës në shkallë 1:500**, punuar mbi genplanin e hartuar nga sektori i Kadastrës së Bashkisë së Tiranës, firmosur me nënshkrim elektronik nga arkitekti.
- 14/ Lidhja me infrastrukturën e në zonë:**
 - Lidhja e strukturës me rrjetin rrugor, nga Sektori i Projektimit (Bashkia e Tiranës) hedhur mbi genplanin e hartuar nga topografët e Bashkisë së Tiranës.
 - Lidhja e strukturës me rrjetin e kanalizimeve, pranë Ujësjetës Kanalizime sh.a, Tiranë.
 - Lidhja e strukturës me rrjetin e ujësjetës, pranë Ujësjetës Kanalizime sh.a, Tiranë.
 - Lidhja e strukturës me rrjetin elektrik, pranë CEZ shpërndarje, Tiranë.
 - Lidhja e strukturës me rrjetin telefonik, pranë ALBtelekom, Tiranë.
 - Lidhja e strukturës me pikën më të afërt të depozitimit të mbetjeve, pranë drejtorisë së Pastrimit dhe Mbetjeve Urbane, Bashkia e Tiranës.
- 15/ Grafiku i kohëzgjatjes së realizimit të punimeve**, i firmosur nga drejtori teknik i subjektit ndërtues dhe nënshkruar elektronikisht nga projektuesi.

16/ Preventivi i realizimit të punimeve i hartuar mbi bazën e çmimeve mesatare, të përcaktuara në aktet ligjore në fuqi.

17/ Raport i Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis (VNM), i nënshkruar elektronikisht

- Dokumenti që vërteton regjistrimin në QKB firmosur me vulë, gjithashtu i firmosur elektronikisht nga eksperti i mjedisit.
- Çertifikata e ekspertit të VNM

18/ Vërtetim nga Instituti i Monumenteve të Kulturës (IMK), në rastet jkur objekti në të cilin kërkohet zhvillimi, është apo ka qenë monument kulture.

19/ Miratim nga Drejtoria e Përgjithshme nr.1 e Punëtorëve të Qytetit, e cila ka për administrim prerjen e drurëve dhe rigjelbërimin e zonës (nëse është e nevojshme, në rastet kur nga projekti preken zona të gjetëra).

20/ Projektet dhe relacionet teknike të strukturës:

- *Projekti arkitektonik i strukturës i nënshkruar elektronikisht*
- *Relacioni teknik i projektit arkitektonik të strukturës i nënshkruar elektronikisht*

- *Projekti konstruktiv i strukturës i nënshkruar elektronikisht*
- *Relacioni teknik i projektit konstruktiv të strukturës i nënshkruar elektronikisht*
- *Studimi sizmologo - inxhinierik*
- *Studimi gjeologo-inxhinierik*

- *Projekti hidro-sanitar strukturës i nënshkruar elektronikisht*
- *Relacioni teknik i projektit hidro-sanitar të strukturës i nënshkruar elektronikisht*

- *Projekti elektrik i strukturës i nënshkruar elektronikisht*
- *Relacioni teknik i projektit elektrik të strukturës i nënshkruar elektronikisht*

- *Projekti i ngrohje - ventilimit i strukturës i nënshkruar elektronikisht*
- *Relacioni teknik i projektit të ngrohje - ventilimit të strukturës i nënshkruar elektronikisht*

- *Projekti i mbrojtjes kundra zjarrit i strukturës i nënshkruar elektronikisht*
- *Relacioni teknik i projektit të mbrojtjes kundra zjarrit i strukturës i nënshkruar elektronikisht*

21/ Deklaratat e përgjegjesisë profesionale (të nënshkruara elektronikisht):

- *Deklaratë e përgjegjesisë profesionale e arkitektit*
- *Deklaratë e përgjegjesisë profesionale e inxhinierit konstruktor*
- *Deklaratë e përgjegjesisë profesionale e inxhinierit hidroteknik*
- *Deklaratë e përgjegjesisë profesionale e inxhinierit elektrik*
- *Deklaratë e përgjegjesisë profesionale e inxhinierit mekanik (ngrohje - ventilimit)*
- *Deklaratë e përgjegjesisë profesionale e ekspertit zjarrëfikës*
- *Deklarata e përgjegjesisë profesionale / ekspertit i vlerësimit mjedisor*

22/ Licencat (të nënshkruara elektronikisht):

- *Licenca e subjektit ndërtues*
- *Licenca e arkitektit*
- *Licenca e inxhinierit konstruktor*
- *Licenca e inxhinierit hidroteknik*
- *Licenca e inxhinierit elektrik*
- *Licenca e inxhinierit mekanik (ngrohje - ventilimit)*
- *Licenca e inxhinierit të mjedisit*
- *Licenca e ekspertit anti-zjarr*
- *Licenca e inxhinierit sizmolog*
- *Licenca e inxhinierit gjeolog*

23/ Policat e sigurimit (të nënshkuara elektronikisht)::

- *Policë sigurimi e arkitektit*
- *Policë sigurimi e inxhinierit konstruktor*
- *Policë sigurimi e inxhinierit hidroteknik*
- *Policë sigurimi e inxhinierit elektrik*
- *Policë sigurimi e inxhinierit mekanik (ngrohje - ventilimit)*
- *Policë sigurimi e eksperit zjarrëfikës*
- *Policë sigurimi e eksperit të VNM-së ose Policë sigurimi e subjektit projektues*
- *Polica e sigurimit e inxhinierit sizmolog*
- *Polica e sigurimit e inxhinierit gjeolog*

24/ Oponenca teknike për të projektet e ndërtimit për të gjitha llojet e punimeve, me vlerë të preventivuar së paku 100 000 000 (njëqind milionë) lekë, e kryer nga Instituti i Ndërtimit dhe Universiteti Politeknik i Tiranës.

25/ Vërtetim për pagesën e tarifës së aplikimit.

➤ NGARKIMI ELEKTRONIK I DOKUMENTAVE

Kërkesa për Leje Ndërtimi paraqitet për shqyrtim nëpërmjet sistemit elektronik të lejeve, i cili mundëson ngarkimin elektronik të dokumentacionit shoqërues të kërkesës për leje ndërtimi.

Lutemi të skanoni të gjitha dokumentat e listuara të cilat do ngarkoni në sistem.

! KUJDES

Përpara ngarkimit të dokumentacionit të nevojshëm për Leje Ndërtimi, sigurohuni që lista e dokumentave të sipërpermendura të jetë e plote.

! KUJDES

Përpara se të ngarkoni dokumentat në rrjet, është i nevojshëm nënshkrimi elektronik i tyre nga hartuesit e projekteve teknike të strukturës.

06 SHQYRTIMI I KËRKESËS & AFATET KOHORE



➤ KOHEZGJATJA E PROCESIT:

MAX 60 DITË PUNE

Procesi kalon në këto hapa:

SHENIM !

Këtu nuk llogaritet 15 ditëshi që i lihet në dispozicion aplikuesit për plotësimin e dokumentacionit.

SHQYRTIMI PËR ÇËSHTJE TË FORMËS

AFATI
5 DITË PUNE

1

Kjo fazë fillon nga momenti që aplikimi protokollohet pranë Bashkisë Tiranë dhe përfundon në momentin që bashkia njofton për plotësim, pranimin apo refuzimin e dokumentacionit.

POZITIV

- Njoftohet subjekti nëpërmjet shkresës "Njoftim për plotësim dokumentacioni".

- Bashkëlidhur kërkeses për plotësim dokumentacioni gjeni dhe Autorizimin "Për pagesën e tarifës për shqyrtimin e kërkesës për leje për punime" ku llogaritet edhe Tarifa e Aplikimit.

- Njoftohet subjekti nëpërmjet shkresës "Njoftim për fillimin e procedurës së shqyrtimit administrativ" bashkëlidhur autorizimi i tarifës së aplikimit.

NEGATIV

Nëse projekti nuk është në përputhje me lejen e zhvillimit/ dokumentet e planifikimit apo personi nuk legjitimohet për të paraqitur kërkesën, grupi i punës përgatit dhe përcjell për miratim tek eprorët vendimin e arsyetuar për refuzimin e kërkesës. Pasi shqyrton materialin e përgatitur, Kryetari i Bashkisë merr vendim të arsyetuar për refuzimin e kërkesës

SHENIM !

Nëse autoriteti përgjegjës, brenda 5 ditëve pune, nuk njofton kërkesin për mangësi në dokumentacion, aplikimi konsiderohet i miratuar në heshtje dhe autoriteti përgjegjës ka detyrimin të vijojë me shqyrtimin e kërkesës.

PLOTËSIMI I DOKUMENTACIONIT NGA APLIKUESI

AFATI
15 DITË PUNE

2

Në rast se dokumentacioni nuk është i plotë, aplikuesi / kërkuesi njoftohet që brenda 15 ditëve pune të kryejë plotësimin e dokumentacionit.

Kjo fazë fillon nga momenti që aplikuesi merr njoftimin nga bashkia dhe përfundon në momentin që aplikuesi ngarkon dokumentacionin përmes sistemit dhe ia dërgon bashkisë. Me dërgimin e njoftimit si më sipër, pezullohet llogaritja e afatit të shqyrtimit të kërkesës deri në plotësimin e dokumentacionit nga ana e aplikuesit/kërkuarit.

POZITIV

Nëse dokumentacioni është i plotë, grupi i punës përgjegjës për shqyrtimin e aplikimit përgatit vërtetimin e pranimit të aplikimit për çështje të formës dhe e përcjell atë për miratim tek eprorët. Këta të fundit, pasi shqyrtojnë materialin e vënë në dispozicion konfirmojnë pranimin për formë.

Bashkëlidhur me dokumentacionin e kërkuar në kërkesën për plotësim dokumentacioni, aplikuesi duhet të ngarkojë dhe Konfirmimin e pagesës së tarifës së aplikimit, lëshuar nga DPTTV e Bashkisë Tiranë.

NEGATIV

Në rast se aplikuesi / kërkuesi nuk dorëzon elektronikisht dokumentacionin e kërkuar brenda afatit të caktuar, aplikimi refuzohet me vendim të arsyetuar ku njoftohet kërkuesi nëpërmjet sistemit elektronik të lejeve.

SHENIM !

Me dërgimin e njoftimit, si më sipër, pezullohet llogaritja e afatit të shqyrtimit të kërkesës deri në plotësimin e dokumentacionit nga kërkuesi.

MENDIMI I INSTITUCIONEVE

AFATI
10 DITË PUNE

3

Në rast se në lidhje me kërkesën për leje duhet të shprehen, paraprakisht, edhe autoritete të tjera publike, brenda kompetencave që u njeh ligji, autoriteti vendor përgjegjës, u dërgon kërkesë për mendim nëpërmjet sistemit elektronik të lejeve.

Në mungesë të përgjigjes së autoriteteve publike nëpërmjet sistemit elektronik të lejeve të ndërtimit, brenda 10 ditëve pune, kërkesa konsiderohet e miratuar në heshtje dhe autoriteti përgjegjës i zhvillimit ka detyrimin të vijojë me shqyrtimin e kërkesës për leje ndërtimi.

SHENIM !

Nëse është e nevojshme, mund të ridërgohet përsëri aplikimi për mendim tek institucionet.

SHQYRTIMI I APLIKIMIT + NDRYSHIMI I PROJEKTIT NGA APLIKUESI

AFATI
10 + 5 DITË PUNE

4

Brenda 10 ditëve pune, nga dhënia e mendimit nga institucioneve, grupi i punës përgjegjës kryen shqyrtimin teknik mbi përputhshmërinë e projektit së bashku me dokumentacionin e plotë shoqëruar të saj me legjislacionin në fuqi.

Brenda ketij afati, ndodh procesi i mëposhtëm:

4.1/ Njoftim për ndryshimin e projektit

Në rast se është e nevojshme që të kryhen ndryshime në projektin e paraqitur, zyra / organi përgjegjës, pranë autoritetit vendor, i dërgon njoftim kërkuarit për kryerjen e tyre, duke dhënë edhe arsyet ligjore përkatëse.

Pasi është lajmëruar për ndryshimin e projektit, pala e interesuar brenda 5 ditëve nga njoftimi i kërkesës duhet të ketë kryer ndryshimet përkatëse.

Autoriteti përgjegjës për shqyrtimin e aplikimit, Ridërgon projektin tek institucionet nëse kanë shprehur mendim negativ për projektin e mëparshëm

SHENIM !

Kërkesa mund të refuzohet në rast se:

- ndryshimet nuk dorëzohen brenda afatit 5-ditor ose nuk pasqyrohen saktësisht në projekt.
- institucionet kanë shprehur mendim negativ

SHENIM !

Riparimitja e kërkesës për leje ndërtimi, pas mospranimit ose refuzimit të saj, trajtohet si kërkesë e re.

4.2/ Raportit të Vlerësimit Teknik (RVT)

Në përfundim të shqyrtimit teknik të përputhshmërisë së projektit me legjislacionin në fuqi përgatitet RVT-ja, i cili duhet të shprehet për përputhshmërinë me instrumentet e planifikimit dhe kontrollit të zhvillimit, rregulloret që shoqërojnë studimet në fuqi, përmbushjen e detyrimeve tekniko-ligjore të dokumentacionit të paraqitur, si dhe propozon për miratimin ose jo të kërkesës për leje ndërtimi.

RVT - ja i përcillet për vendimarrje, nëpërmjet sistemit elektronik të lejeve, Drejtorit të Përgjithshëm të DPPZHT. Pasi shqyrton Raportin e Vlerësimit Teknik (RVT), Drejtori i Përgjithshëm i DPPZHT konfirmon pranimin e kërkesës duke e përcjelle atë tek Sekretariati Teknik për përgatitjen e Vendimit të Kryetarit dhe autorizimit për taksën e ndikimit në infrastrukturë.

4.3/ Opinioni i i keshillit teknik

Vlerësim i kërkesës për leje ndërtimi kryhet nga Këshilli Teknik (KT) në mbështetje të Raportit të Vlerësimit Teknik. KT në përfundim të çdo tematike, jep mendimin e tij për çështjet e shqyrtuara dhe bën propozimet, të cilat i paraqiten Kryetarit të Bashkisë për vendimarrje.

4.4/ Vendimi i Kryetarit

Materiali i përgatitur i përcillet Kryetarit të Bashkisë, i cili pasi e kontrollon vendos:

PRANIMIN E KËRKESËS

Njofton aplikuesin / kërkuarin nëpërmjet sistemit elektronik të lejeve lidhur me vendimin, planvendosjen dhe detyrimin për kryerjen e pagesës së taksës së ndikimit në infrastrukturë.

REFUZIMIN E KËRKESËS

Kthen sërish për shqyrtim kërkesën për leje ndërtimi.

TAKSA E NDIKIMIT NE INFRASTRUKTURË

AFATI 15 DITË PUNE

5

Baza e taksës është vlera në lekë e investimit të ri që kërkohet të kryhet ose vlera në lekë e çmimit të shitjes / m² të investimit të ri. Klasifikimi si investim i ri përcaktohet në përputhje me legjislacionin në fuqi për dhënien e lejes së ndërtimit.

Detyrimi për pagesën e taksës i takon investitorit. E ardhura nga taksa, për çdo rast, mbledhet nga organi që lëshon lejen e ndërtimit dhe arkëtohet, për çdo rast, për llogari të bashkisë, që mbulon territorin ku do të bëhet investimi.

Struktura e ngarkuar për përlogaritjen dhe lëshimin e autorizimit për pagesën e taksës së ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet e reja është Drejtoria e Përgjithshme e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit dhe të ardhurat arkëtohen nga Drejtoria e Përgjithshme e Taksave dhe Tarifave Vendore.

Niveli i taksës ndryshon në varësi të llojit të ndërtimit.
SHIH HAPIN 07.

SHËNIM !

Shih faqen pasardhëse për sqarim të procedurës së pagesës për taksën e ndikimit në infrastrukturë.

KUJDES !

Nëse nga ana e aplikuesit brenda këtij afati nuk ngarkohen në sistem aktet që provojnë pagesën e kryerjes së taksës së ndikimit në infrastrukturë, atëherë Kryetari i Bashkisë i dërgon nëpërmjet sistemit elektronik të lejeve aplikuesit, vendimin e refuzimit të lejes së ndërtimit.

FORMULARI I LEJES SE NDERTIMIT

AFATI, 5 DITË PUNE

6

Kryetari i Bashkisë, brenda 5 ditëve pune nga përmbushja e kushteve të përcaktuara më sipër, i dërgon aplikuesit nëpërmjet sistemit elektronik, lejen e ndërtimit, të nënshkruar elektronikisht prej tij.

07 **PAGESA E TARIFES SE APLIKIMIT PAGESA E TAKSËS SË NDIKIMIT NË INFRASTRUKTURË**



➤ TARIFA E PAGESËS SË TARIFËS DHE TAKSAVE

Bashkia e Tiranës lëshon autorizimet online:

“Për pagesë tarife shqyrtimi, leje ndertimi”
“Për pagesën e taksës së ndikimit në infrastrukturë”

SHENIM !

Nëse nga ana e aplikuesit brenda afateve ligjore nuk ngarkohen në sistem aktet që provojnë pagesën e kryerjes së tarifës së aplikimit dhe taksës së ndikimit në infrastrukturë, atëherë Kryetari i Bashkisë i dërgon nëpërmjet sistemit elektronik të lejeve aplikuesit, vendimin e refuzimit të lejes së ndërtimit.

Për të kryer **Tarifën e aplikimit** dhe **Taksën e ndikimit në infrastrukturë** për leje ndertimi kalohet në disa hapa:

- 1/ AUTORIZIMI I TARIFES SE APLIKIMIT** - Në bazë të autorizimit të hartuar nga Bashkia e Tiranës merret dokumenti për kryerjen e pagesës në banke, pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Taksave dhe Tarifave Vendore (DPTTV) të Bashkisë Tiranë.
- 1/ PAGESA E TARIFËS NË BANKË** - Nëpërmjet dokumentit të leshuar nga DPTTV-ja bëhet pagesa në bankë.
- 1/ KONFIRMIMI I PAGESËS** - Me mandat - pagesën bankare merret konfirmimi i pagesës pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Taksave dhe Tarifave Vendore (DPTTV) të Bashkisë Tiranë, i cili ngarkohet në sistem brenda afatit ligjor të percaktuar.

PAGESA E TAKSËS SË NDIKIMIT NË INFRASTRUKTURË

Baza e taksës është vlera në lekë e investimit të ri që kërkohet të kryhet ose vlera në lekë e çmimit të shitjes / m² të investimit të ri. Klasifikimi si investim i ri përcaktohet në përputhje me legjislacionin në fuqi për dhënien e lejes së ndërtimit.

Detyrimi për pagesën e taksës i takon investitorit. E ardhura nga taksa, për çdo rast, mbledhet nga organi që lëshon lejen e ndërtimit dhe arkëtohet, për çdo rast, për llogari të bashkisë, që mbulon territorin ku do të bëhet investimi.

Struktura e ngarkuar për përlogaritjen dhe lëshimin e autorizimit për pagesën e taksës së ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet e reja është Drejtoria e Përgjithshme e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit dhe të ardhurat arkëtohen nga Drejtoria e Përgjithshme e Taksave dhe Tarifave Vendore.

Niveli i taksës, është si vijon:

➤ 8% të çmimit të shitjes / m² të sipërfaqeve të shfrytëzueshme

Kjo taksë aplikohet për ndërtime për qëllime banimi apo njësi shërbimi nga shoqëritë e ndërtimit të cilat nuk destinohen për përdorim në sektorin e turizmit, industrisë apo përdorim publik.

Në rastet e shitjes së ndërtesave që nuk janë apartamente banimi, çmimi minimal i shitjes / m² sipërfaqe ndërtimi, përcaktohet si më poshtë:

a/ Çmimi / m² sipërfaqe ndërtimi për veprimtari tregtimi dhe shërbimi është është 2 herë më i lartë se çmimi i sipërfaqeve të banimit sipas qyteteve. Në këtë kategori do të përfshihen edhe ndërtesa tregtare, ku njëkohësisht realizohen edhe procese të përziera prodhim, tregtim ose/edhe shërbime me pakicë.

b/ Çmimi / m² sipërfaqe ndërtimi për parkim të mbuluar dhe bodrume është 70 % e çmimit të sipërfaqeve të apartamenteve të banimit sipas qyteteve.

◀ SHËNIM

Sipas udhëzimit nr.29,
dt.30.07.2018 “Për tatimin e kalimit
të së drejtës së pronësisë së
pasurisë së paluajtshme”

ç/ Çmimi / m2 sipërfaqe ndërtimi për parkim i hapur është 30 % e çmimit të sipërfaqeve të apartamenteve të banimit sipas qyteteve.

SHENIM !

Çmimi i shitjes për metër katror bazohet në vlerën referuese të vlerës së tregut, sipas përcaktimeve në udhëzimin e Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e kostos mesatare të ndërtimit të banesave nga Enti Kombëtar i Banesave", që miratohet çdo vit.

➤ 4% e vlerës së investimit të ndërtimit të ri

Taksa aplikohet mbi llojet e ndërtimeve të ndryshme nga rastet ku aplikohet taksa mbi cmimin referues të shitjes (8%).

SHENIM !

Vlera e investimi llogaritet sipas kostos mesatare të ndërtimit të banesave të miratuar nga Enti Kombëtar i Banesave ose preventivin e investimit të paraqitur nga subjekti i interesuar dhe përzgjidhet vlerën më të lartë midis të dyjave.

➤ 2% e vlerës së investimit të ndërtimit

Taksa aplikohet mbi ndërtimet me **funksione publike me investime dhe/ose grante që i jepen institucioneve shtetërore,**

SHENIM !

Vlera e investimi llogaritet sipas kostos mesatare të ndërtimit të banesave të miratuar nga Enti Kombëtar i Banesave ose preventivin e investimit të ri të paraqitur nga subjekti i interesuar dhe përzgjidhet vlerën më të lartë midis të dyjave.

➤ 0.1% e vlerës së investimit të ndërtimit

Taksa aplikohet për projektet e infrastrukturës, për ndërtimin e rrugëve kombëtare, të porteve, aeroporteve, tuneleve, digave, ndërtimit të infrastrukturës në energji, përfshirë makineritë dhe pajisjet për këto projekte, por jo më pak se kostoja e rehabilitimit të infrastrukturës së dëmtuar, kur kjo kosto nuk është përfshirë në preventivin e investimit.

➤ 0.5% e vlerës së investimit të ndërtimit

Taksa aplikohet për ndërtesat, të cilat janë në proces legalizimi.

SHENIM !

Vlera e investimi llogaritet sipas kostos mesatare të ndërtimit të banesave të miratuar nga Enti Kombëtar i Banesave.

KUJDES !

- Për kategoritë ku niveli i taksës aplikohet mbi vlerën e investimit, në përfundim të punimeve të kryera sipas lejes së miratuar, bëhet kontrolli i pagesave me situacionin përfundimtar të objektit të ndërtuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit. dhe nëse ka diferenca mes vlerës së investimit sipas situacionit përfundimtar dhe preventivit, njoftohet subjekti për vlerën e diferencës që është i detyruar të shlyejë. Mosshlyerja e këtij detyrimi përbën shkak për pezullimin e procedurave të paisjes me leje përdorimi të subjektit.

- Nëse objekti, për të cilin do të bëhet investimi, shtrihet në territorin e më shumë se një bashkie ose kur objekti ndikon në infrastrukturën e një bashkie tjetër, të ardhurat nga taksa ndahen proporcionalisht ndërmjet tyre, në përputhje me raportet përkatëse të shtrirjes së objektit dhe të ndikimit të investimit në infrastrukturën e secilës bashki.

! PËRJASHTIME

Përfshihen nga detyrimi i pagesës së Taksës së Ndikimit në Infrastrukturë nga ndërtimet e reja shoqëritë me kapital të zotëruar nga Bashkia e Tiranës në masën 100% dhe ndërmarrjet e Bashkisë Tiranë për të gjitha ndërtimet e reja apo ndërhyrjet rehabilituese në infrastrukturën ku investor apo përfitues i një projekti të financuar nëpërmjet granteve apo huave janë këto të fundit.

➤ AFATET KOHORE_PËR NDËRTIMET E REJA

Taksa paguhet brenda **15 DITËVE nga data e marrjes së vendimit për miratimin e lejes për punime dhe lëshimit të autorizimit të pagesës** nga Drejtoria e Përgjithshme e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit.

Nëse në përfundim të këtij afati kërkuesi ende nuk ka paguar detyrimin, Kryetari i Bashkisë vendos masa të tjera të përshtatshme, deri në revokimin e vetë lejes së miratuar.

➤ AFATET KOHORE_PËR NDËRTIMET PROCES LEGALIZIMI



Struktura e ngarkuar për përlogaritjen dhe arkëtimin e taksës së ndikimit në infrastrukturë për ndërtesat në proces legalizimi është **Drejtoria e Përgjithshme e Taksave dhe Tarifave Vendore**.

Taksa paguhet nga individ / subjekti i interesuar në çdo moment dhe gjithësesi jo më vonë se **45 DITË nga data e dhënies së lejes së legalizimit nga ALËIZN**

Nëse subjekti / personi i interesuar nuk kryen pagesën brenda këtij afati, atëherë për çdo ditë vonesë i llogaritet **kamatë 0,1% në ditë e shumës që duhet të paguajë, deri në 30 ditë pune**.

PËRMBLEDHJA E PROCESIT TË APLIKIMIT PËR LEJE NDËRTIMI





KONTROLLI I KUSHTEVE TË ZHVILLIMIT & PËRCAKTIMEVE PËR PRONËN

REFERUAR PPV TIRANË PDV FAZA I PDV FAZA II LEJES SË ZHVILLIMIT

Përpara se të aplikoni për Leje ndërtimi, kontrolloni kushtet e zhvillimit që përcaktohen në rast se:

1/ Prona që ju doni të zhvilloni ndodhet në njësi strukturore subjekt PDV-je, përcaktuar si e tillë nga Plani i Përgjithshëm Vendor i Bashkisë Tiranë (TR030), kushtet për ndërtim i përcakton hartimi i PDV-së (Faza I dhe Faza II).

ose

2/ Prona juaj ndodhet në njësi strukturore që nuk është subjekt PDV-je, ju mund të aplikoni direkt për Leje Zhvillimi, e më pas për Leje Ndërtimi.

PAJISJA ME STATUSIN JURIDIK TË PRONAVE PËR NJËSINË STRUKTURORE NGA ZVRPP

Pranë Zyrave Vendore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme (ZVRPP) aplikohet për dokumentat e mëposhtme:

- 1/ Çertifikata e pronësisë
- 2/ Kartela e pasurisë së paluajtshme
- 3/ Harta treguese e regjistrimit

APLIKIMI PËR GEN-PLAN AZHORNIMI NË BASHKINË E TIRANËS

GEN-PLANI I AZHORNIMIT nga GIS Kadastra e Bashkisë Tiranë i pronës është rievimi topografik i gjendjes ekzistuese të saj në të cilën përcaktohet dhe rrjeti i propozuar i infrastrukturës në zonë, referuar përcaktimeve të studimeve në fuqi (PPV, PDV Faza 1, PDV Faza 2, Leje Zhvillimi).

Dokumentat e nevojshëm për aplikimin për GEN - PLAN:

- 1/ RILEVIMI TOPOGRAFIK I TERRITORIT NË PRONËSË
 - Realizohet nga një topograf i licensuar.
 - shkalla në varësi të sipërfaqes së zonës
 - formati A3 (e printuar dhe digjitale - CD)
 - firmosur nga ekspert i licensuar

- 2/ VËRTETIMIN E PRONËSISË NGA HIPOTEKA (ZVRPP) (SHIKO HAPIN 2)
 - çertifikata e pronësisë
 - kartela e pasurisë së paluajtshme
 - harta treguese e regjistrimit

3/ LICENSA E TOPOGRAFIT E NOTERIZUAR

!KUJDES

Përpara aplikimit për azhormim në Bashkinë Tiranë aplikanti duhet të ketë kryer nëpërmjet një eksperti gjeodet të licensuar rievimin topografik të zonës.

HARTIMI I PROJEKTEVE TEKNIKE TË STRUKTURËS

4.1/ Projekti arkitektonik

4.2/ Projekti konstruktiv i strukturës

4.3/ Projekti hidro-sanitar i strukturës

4.4/ Projekti elektrik i strukturës

4.5/ Projekti i ngrohje-ventilimit të strukturës

4.6/ Projekti i mbrojtjes kundra zjarrit të strukturës

PËRGATITJA E DOKUMENTACIONIT TEKNIKO - LIGJOR & APLIKIMI ONLINE

1/ Formati i aplikimit i nënshkruar elektronikisht

2/ Prokura ose autorizim nga zhvilluesi, në emër të aplikantit (projektuesit) për kryerjen e aplikimit për leje ndërtimi.

3/ Leja e zhvillimit e miratuar/ PDV. SHIH HAPIN 01

4/ Dokument që vërteton të drejtat pasurore të pronës/ave që marrin pjesë në zhvillim dhe, nëse ka, kopje të marrëveshjeve për pronën si: çertifikata e pronësisë, kartela e pronësisë & harta treguese. (SHIKO HAPIN 02)

5/ Historiku i pronës, nëse kërkohet

6/ Kontratë sipërmarrje, e lidhur midis zhvilluesit, pronarëve të truallit (apo përfaqësuesit të tyre me prokurë) dhe subjektit ndërtues që do të kryej punimet, e cila duhet të jetë origjinale dhe e lidhur para noterit.

7/ Deklaratë materiale për kallkan në rastet kur është i nevojshëm.

8/ Deklaratë materiale për prishjen e objekteve ekzistues në rastet kur zhvillimi parashikon prishjen e tyre për ndërtimin e strukturës së re.

9/ Licenca e subjektit ndërtues, me kategoritë përkatëse të punimeve që do të kryhen, brenda afatit të vlefshmërisë. Subjekti duhet të jetë i regjistruar pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit dhe duhet të paraqesë ekstraktin e regjistrimit në QKB të 3 muajve të fundit.

Kërkesa për Leje Ndërtimi paraqitet për shqyrtim nëpërmjet sistemit elektronik të lejeve, i cili mundëson ngarkimin elektronik të dokumentacionit shoqërues të kërkesës për leje ndërtimi.

Lutemi të skanoni të gjitha dokumentat e listuara të cilat do ngarkoni në sistem:

!KUJDES

Përpara ngarkimit të dokumentacionit të nevojshëm për Leje Ndërtimi, sigurohuni që lista e dokumentave të sipërpermdura të jetë e plote.

!KUJDES

Përpara se të ngarkoni dokumentat në rrjet, është i nevojshëm nënshkrimi elektronik i tyre nga hartuesit e projekteve teknike të strukturës.

shpërndarje, Tiranë.

- Lidhja e strukturës me rrjetin telefonik, pranë ALBtelekom, Tiranë.
- Lidhja e strukturës me pikën më të afërt të depozitimit të mbetjeve, pranë drejtorisë së Pastrimit dhe Mbetjeve Urbane, Bashkia e Tiranës.

15/ Grafiku i kohëzgjatjes së realizimit të punimeve, i firmosur nga drejtori teknik i subjektit ndërtues dhe nënshkruar elektronikisht nga projektuesi.

16/ Preventivi i realizimit të punimeve i hartuar mbi bazën e çmimeve mesatare, të përcaktuara në aktet ligjore në fuqi.

17/ Raport i Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis (VNM), i nënshkruar elektronikisht

- Dokumenti që vërteton regjistrimin në QKB firmosur me vulë, gjithashtu i firmosur elektronikisht nga eksperti i mjedisit.
- Çertifikata e ekspertit të VNM

18/ Vërtetim nga Instituti i Monumenteve të Kulturës (IMK), në rastet jkur objekti në të cilin kërkohet zhvillimi, është apo ka qenë monument kulture.

19/ Miratim nga Drejtoria e Përgjithshme nr.1 e Punëtorëve të Qytetit, e cila ka për administrim prerjen e drurëve dhe rigjellbërimit e zonës (nëse është e nevojshme, në rastet kur nga projekti preken zona të gjobërta).

20/ Projektet dhe relacionet teknike të strukturës:

- Projekti arkitektonik i strukturës i nënshkruar elektronikisht

i nënshkruar elektronikisht

- Projekti konstruktiv i strukturës i nënshkruar elektronikisht
- Relacioni teknik i projektit konstruktiv të strukturës i nënshkruar elektronikisht
- Studimi sizmologo - inxhinierik
- Studimi gjeologjiko-inxhinierik

- Projekti hidro-sanitar strukturës i nënshkruar elektronikisht
- Relacioni teknik i projektit hidro-sanitar të strukturës i nënshkruar elektronikisht

- Projekti elektrik i strukturës i nënshkruar elektronikisht
- Relacioni teknik i projektit elektrik të strukturës i nënshkruar elektronikisht
- Projekti i ngrohje - ventilimit i strukturës i nënshkruar elektronikisht
- Relacioni teknik i projektit të ngrohje - ventilimit të strukturës i nënshkruar elektronikisht

- Projekti i mbrojtjes kundra zjarrit i strukturës i nënshkruar elektronikisht
- Relacioni teknik i projektit të mbrojtjes kundra zjarrit i strukturës i nënshkruar elektronikisht

21/ Deklaratat e përgjegjësisë profesionale (të nënshkuara elektronikisht):

- Deklaratë e përgjegjësisë profesionale e arkitektit
- Deklaratë e përgjegjësisë profesionale e inxhinierit konstruktor
- Deklaratë e përgjegjësisë profesionale e inxhinierit hidroteknik
- Deklaratë e përgjegjësisë profesionale e inxhinierit elektrik



SHQYRTIMI I KËRKESËS, AFATET KOHORE, & PAGESA E TARIFES SE APLIKIMIT

- Deklaratë e përgjegjësisë profesionale e inxhinierit mekanik (ngrohje - ventilimit)
- Deklaratë e përgjegjësisë profesionale e ekspertit zjarrëfikës
- Deklarata e përgjegjësise profesionale / eksperti i vlerësimit mjedisor

22/ Licencat (të nënshkuara elektronikisht):

- Licenca e subjektit ndërtues
- Licenca e arkitektit
- Licenca e inxhinierit konstruktor
- Licenca e inxhinierit hidroteknik
- Licenca e inxhinierit elektrik
- Licenca e inxhinierit mekanik (ngrohje - ventilimit)
- Licenca e inxhinierit të mjedisit
- Licenca e ekspertit anti-zjarr
- Licenca e inxhinierit sizmolog
- Licenca e inxhinierit gjeolog

23/ Policat e sigurimit

(të nënshkuara elektronikisht):

- Policë sigurimi e arkitektit
- Policë sigurimi e inxhinierit konstruktor
- Policë sigurimi e inxhinierit hidroteknik
- Policë sigurimi e inxhinierit elektrik
- Policë sigurimi e inxhinierit mekanik (ngrohje - ventilimit)
- Policë sigurimi e ekspertit zjarrëfikës
- Policë sigurimi e ekspertit të VNM-së ose Policë sigurimi e subjektit projektues
- Polica e sigurimit e inxhinierit sizmolog
- Polica e sigurimit e inxhinierit gjeolog

24/ Oponenca teknike për të projektet e ndërtimit për të gjitha llojet e punimeve, me vlerë të preventivuar së paku 100 000 000 (njëqind milionë) lekë, e kryer nga Instituti i Ndërtimit.

25/ Vërtetim për pagesën e tarifës së aplikimit.



TAKSA E NDIKIMIT NË INFRASTRUKTURË

Kohëzgjatja e procesit është max 60 ditë pune. (Këtu nuk përfshihen 15 ditët e punës që i lihen në dispozicion aplikuesit për plotësimin e dokumentacionit).

Procesi kalon në këto hapa:

- 1/ Shqyrtim për çështje të formës
- 2/ Plotësimi i dokumentacionit nga aplikuesi
- 3/ Mendimi i institucioneve
- 4/ Shqyrtimi i aplikimit + ndryshimi i projektit nga aplikuesi

- 4.1/ Njoftim për ndryshimin e projektit
- 4.2/ Raporti i Vlerësimit Teknik (RVT)
- 4.3/ Opinioni i Këshillit Teknik
- 4.4/ Vendimi i Kryetarit

Baza e taksës është vlera në lekë e investimit të ri që kërkohet të kryhet ose vlera në lekë e çmimit të shitjes / m² të investimit të ri. Klasifikimi si investim i ri përcaktohet në përputhje me legjislacionin në fuqi për dhënien e lejes së ndërtimit.

Detyrimi për pagesën e taksës i takon investitorit. E ardhura nga taksa, për çdo rast, mbledhet nga organi që lëshon lejen e ndërtimit dhe arkëtohet, për çdo rast, për llogari të bashkisë, që mbulon territorin ku do të bëhet investimi.

Struktura e ngarkuar për përlogaritjen dhe lëshimin e autorizimit për pagesën e taksës së ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet e reja është Drejtoria e Përgjithshme e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit dhe të ardhurat arkëtohen nga Drejtoria e Përgjithshme e Taksave dhe Tarifave Vendore.

Niveli i taksës ndryshon në varësi të llojit të ndërtimit.

SHIH HAPIN 07.



FORMULARI I LEJES SE NDERTIMIT

Kryetari i Bashkisë, brenda 5 ditëve pune nga përmbushja e kushteve të përcaktuara më sipër, i dërgon aplikuesit nëpërmjet sistemit elektronik, lejen e ndërtimit, të nënshkuar elektronikisht prej tij.

REFERENCA LIGJORE DHE ADMINISTRATIVE:

- Ligji 107/2014 dt. 31/07/2014 (i ndryshuar) “Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit”
- VKM 686 dt.22/11/2017 “Për Miratimin e Rregullores së Planifikimit të Territorit”
- VKM 408 dt. 13/05/2015 (i ndryshuar) “Për Miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territorit”
- VKKT nr.1, dt.14.04.17 “Rregullore e Planit të Përgjithshëm Vendor të Bashkisë Tiranë”
- Ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 për “Sistemin e taksave dhe tarifave vendore” (i ndryshuar)
- Vendimin e Këshillit Bashkiak nr. 59, datë 30.12.2015 për “Sistemin e taksave dhe tarifave vendore në qytetin e Tiranës” (i ndryshuar)
- Udhëzimit të KM nr.3, datë 28.12.2016, për “Miratimin e kostos mesatare të ndërtimit të banesave nga Enti Kombëtar i Banesave” për vitin 2016
- Udhëzim i përbashkët nr. 29, Datë 30.7.2018 Për tatimin e kalimit të së drejtës së pronësisë së pasurisë së paluajtshme

Udhëzuesi **“Si të aplikosh për Leje Ndërtimi”**,
është pjesë e një pakete informative për zbatimin e bazës tekniko - ligjore sipas kushteve të
zhvillimit të përcaktuara në legjisllacionin dhe rregulloret përkatëse në fuqi, së bashku me:

Udhëzuesin “Si të aplikosh për Leje Zhvillimi”
Udhëzuesin “Si të aplikosh për konfirmim e Akt-kontrolleve”
Udhëzuesin “Si të aplikosh për çertifikatë përdorimi”
Udhëzuesin “Si të aplikosh për Plan të Detajuar Vendor”
Udhëzuesin “Si të aplikosh për Deklaratë Paraprake për Kryerje Punimesh”
Udhëzuesin “Si të aplikosh për Gen-plan Azhornimi”

Përgatitur nga Bashkia e Tiranës me mbështetje teknike të
Drejtorisë së Përgjithshme të Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit.

Sheshi “Skënderbej”,
Nd. 2, Kodi postar 1001,
Tiranë, Shqipëri

www.tirana.al